



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

Bazuar në nenin 3 dhe 4 të Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikanteve në Gjykata, për praktikantë vullnetarë (pa pagesë), për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti,

Gjykata Themelore në Ferizaj

Shpall:

K O N K U R S
Nr.01/2018

Titulli i vendit të punës: Praktikantë

1. Gjykata Themelore në Ferizaj 10 (dhjetë) pozita,
2. Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik 3 (tri) pozita dhe
3. Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpçë 2(dy) pozita.

Pozita Nr.1

Titulli i pozitës: Praktikantë

Vendi i punës: Gjykata Themelore në Ferizaj

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti (pa pagesë)

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Administratori i Gjykatës

Pozita Nr.2

Titulli i pozitës: Praktikantë

Vendi i punës: Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti (pa pagesë)

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Ndhmës Administratori

Pozita Nr.3

Titulli i pozitës: Praktikantë

Vendi i punës: Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpçë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti (pa pagesë)

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Ndhmës Administratori

Përshkrimi i detyrave të punës:

Detyrat e praktikantit: Ndhmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore:

- Vepron nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Administratorit të Gjykatës / Ndhmës Administratorit.
- Ndhmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi;
- Ndhmon gjyqtarët në punët që kanë të bëjnë me futjen e shkresave të lëndëve në dosje;
- Ndhmon në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë / Degë të Gjykatës duke përfshirë regjistrimin e shkresave të lëndës etj,
- Ndhmon në kryerjen e hulumtimeve ligjore, përgatitjen e memorandumeve të politikave dhe memorandumeve ligjore,
- Bënë hartimin e draft vendimeve, urdhëresave, opinionëve dhe
- Punë të tjera sipas nevojave të Gjykatës.

Kualifikimet:

- Diploma e Fakultetit Juridik, programi i studimeve 4 (katër) vjeçare, apo 240 kredi ECTS ose Master;
- Njohuri të procedurave gjyqësore;
- Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- Njohuri të mjaftueshme ligjore dhe
- Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë për përpilimin e dokumenteve ligjore si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

VËREJTJE:

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatë të jashtëm.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara **me Ligjin mbi Shërbimin Civil, Nr. 03/L- 149**, Rregullores, Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregullores Nr. 08/2017 për Praktikantë në Gjykata dhe Sekretariatit e SKGJK-së.
- **Konkursi është publikuar me datë 07.02.2018 dhe mbyllet me datë 21.02.2018.**

Aplikacionet mund t'i merrni në **Zyrën e Pranimit** në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Rr. Sali Çeku" pn. dhe po ashtu, aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Web portalin e Gjykatës Themelore në Ferizaj: www.gjyqesori-rks.org .

[Shkarko Aplikacionin](#)

Aplikacionet e plotësuar mund t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Rr. Sali Çeku" pn. si dhe përmes postës - kodi postar 70000.

- Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, si specifikohet në Nenin 11, par.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkuron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:
 - kopja e letërnjoftimit,
 - diploma për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale,
 - certifikata që nuk jeni nën hetime, certifikata të tjera, etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë t'i tërheqin prapa.
- Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësie mund të kontaktoni në numrat e tel./fiks: **0290/ 321 009 dhe 0290/ 320 261.**